

Biseda mësimore


Biseda mësimore 5.1



Pikëqëndrimi i punës së mësimdhënësit dhe instruktorit në shkollat e mesme profesionale është pamëdyshje bartja e njohurive të fituara, të nxënësve tuaj, gjatë mësimit teorik në mësim praktik (në punëtori).

- Në bisedë mësimore kemi ndërmjetësim të njohurive respektivisht shpesh edhe përpunim të diturive të reja. Sidomos, trajtohen përmbajtjet mësimore thelbësore dhe ato të rëndësishme.
- Biseda mësimore drejtohet nga mësimdhënësi, po në asnjë mënyrë nuk mund të paraplanifikohet dhe parastrukturohet qartë, siç është rasti tek mësimi i punës praktike.
- Biseda mësimore shtron kërkesa të larta në teknikën pyetëse të mësimdhënësit. Përmes pyetjeve qëllimore nxënësit nxiten për pavarësi në të menduar dhe mësuar.
- Në fillim mësimdhënësi i parashtron pyetjen gjithë grupit, ndërsa përmes kësaj u jemi drejtuar të gjithëve. Nxënësit kanë mundësi të bollshme për tu drejtuar pyetje mësimdhënësve.

Në profesionet shkollore me një % më të lartë të pjesës teorike, bisedat mësimore zhvillohen më shpesh sesa në profesionet ku mbizotëron puna e dorës!



Në bisedë mësimore janë aktivë edhe nxënësit . Për këtë arsye dhe të mësuarit këtu, mbahet më mirë në mend dhe gabimet eventuale apo jokorrektësitë e paraqitura mund të sqarohen menjëherë.

Rritja e nivelit të diturisë mund të vërtetohet aty për aty dhe në bazë të kësaj mësimdhënësi përcakton hapat e mëtejme.

Shtrimi i pyetje gjatë gjatë bisedës mësimore

Gjatë një bisede mësimore duhet të parashtroni vetëm pyetje të hapura. Nxënësit mund të shprehen lirisht lidhur me pyetjet e bëra. Pyetjet të cilat bazohen ekskluzivisht në qëllimin e mësimi. Ato fillojnë me një fjalë pyetëse

Shembulli: Cilat përparësi i kanë akumulatorët në krahasim me elementet zink-karbon?

Në rast të përgjigjes së gabuar, duhet parashtruar pyetje të tjera të cilat do ta shpiejnë nxënësin në drejtim të caktuar.

Shembulli: Mendohuni ju lutem njëherë, pse ju për një bateri dore përdorni akumulator e jo elemente prej zink-karboni?

Me anë të pyetjeve pasuese, plotësuese, mundeni edhe më tej ti thelloni dhe zhvilloni disa aspekte nga përgjigjet e mëparshme të nxënësit.